

Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024



Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024

Impresum

Titulli:

Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024

Botues:

Daniel Braun, Përfaqësues zyrtar i Fondacionit Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Marko Troshanovski, Kryetar i Institutit për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup

Autorë:

Gjorgji Haxhi Vasilev

Joana Treneska

Tome Smilevski

Bashkërendimi:

Davor Pasoski, Menaxher programi, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Disejni dhe përgatitja:

Vinsent Grafika DOO Shkup

Publikimi mund të merret falas në:

www.izbornaarhiva.mk

<https://www.kas.de/mk/web/nordmazedonien/>

<http://www.idscs.org.mk>

I shprehim mirënjohje Programit për mbështetjen zgjedhore të bashkëpunimit Zviceran në Maqedoninë e Veriut, të zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES), për mbështetjen dhe bashkëpunimin në përgatitjen e këtij publikimi.

Vërejtje:

Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ - Shkup nuk janë përgjegjës për faktet dhe pikëpamjet e shprehura në publikim. Ato përfaqësojnë pikëpamjet personale të autorit.

Ky publikim është vetëm për qëllime informative dhe informacioni në të nuk mund të përdoret në fushatat zgjedhore.

Përmbajtja

Hyrje në zgjedhjet e shtata presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut	5
---	----------

Përgatitjet për zgjedhjet presidenciale.....	13
Ndryshimet e fundit në legjislacionin zgjedhor.....	15

1. Historiku i zgjedhjeve presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1991-2019)	21
---	-----------

2. Sistemi zgjedhor i Maqedonisë për zgjedhjet presidenciale	25
---	-----------

3. Pjesëmarrësit në zgjedhjet presidenciale 2024	29
---	-----------

Stevo Pendarovski.....	31
Gordana Siljanovska Davkova	32
Stevço Jakimovski.....	34
Bujar Osmani.....	35
Biljana Vankovska Cvetkovska.....	37
Arben Taravari.....	38
Maksim Dimitrievski.....	39

Hyrje

Hyrje në zgjedhjet e shtata presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Zgjedhjet e shtata presidenciale në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 24 prill të vitit 2024. Për postin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të garojnë 7 kandidatë: kryetari aktual dhe kandidati i Lidhjes socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM), Stevo Pendarovski, kandidatja e organizatës së brendshme revolucionare maqedonase – Partia demokratike për unitetin kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE), Gordana Siljanovska Davkova, kandidatja e partisë E majta - Levica, Biljana Vankovska Cvetkovska, kandidati i Bashkimit demokratik për integrim (BDI), Bujar Osmani, kandidati i koalicionit „Vlen“, Arben Taravari, kandidati i “Lëvizjes ZNAM – Për Maqedoninë tonë”, Maksim Dimitrievski dhe kandidati i Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM), Stevço Jakimovski.

Zgjedhjet presidenciale u shpallën me datë 14.2.2024, kur kryetari i Kuvendit, Jovan Mitrevski, në pajtim me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e nënshkroi vendimin për shpalljen e zgjedhjes për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut .¹

Në pajtim me vendimin, rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të mbahet më 24 prill të vitit 2024, ndërsa rrethi i dytë eventual zgjedhor do të mbahet më 8 maj të vitit 2024, njëkohësisht me mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta parlamentare.

Më 14 shkurt, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ) miratoi kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President të shtetit.²

Në pajtim me Kalendarin e afateve, procedura e mbledhjes së nënshkrimeve për kandidatët për president filloi më 23 shkurt, ndërsa mbaroi më 8 mars në orën 24. Mbledhja e nënshkrimeve u zhvillua para të gjitha njësisve rajonale dhe zyrave të KSHZ-së, të vendosura në selitë e 34 vetëqeverisjeve lokale dhe para organeve kompetente.

1 Vendim për shpalljen e zgjedhjeve <https://drive.google.com/file/d/1LgvXvn7cx3lWbxLchlxEZY0cjiKqYB/view> (vizita e fundit 25.03.2024)

2 Kalendar i afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President të Republikës së Maqedonisë së Veriut https://drive.google.com/file/d/1iN8Gim1W542gkDasz_aDHK0pX_43dEcZ/view (vizita e fundit 25.03.2024)

Sipas të dhënave të KSHZ-së, 7 nga gjithsej 15 kandidatë i mblodhën 10.000 nënshkrimet e nevojshme për pjesëmarrje në zgjedhjet presidenciale. Kandidatët nga VMRO-DPMNE-ja, Gordana Siljanovska -Davkova dhe nga LSDM-ja, Stevo Pendarovski edhe krahas mbështetjes nga partitë politike, kandidaturat i vërtetuan me mbledhjen e nënshkrimeve.³ Pretendentët Vello Markovski, Mersiha Smailloviq, Gjorgji Manaskov, Zorica Cvetkovska, Gospodin Poposki, Tome Nikollovski, Goce Ristov dhe Dragan Nikollovski nuk i mblodhën nënshkrimet e nevojshme.⁴

Kryetari aktual, Stevo Pendarovski, më 1.3.2024, shpalli zyrtarisht se sërish do të kandidohet për postin. Në garën për mandatin e dytë, Pendarovski theksoi se ka marrë mbështetje publike nga një numër i madh qytetarësh, një pjesë e tyre janë personalitete publike, profesorë dhe punonjës të kulturës. LSDM-ja në kongresin që u mbajt më 3.3.2024 me 706 vota „pro“ mori vendim për mbështetjen zyrtare të Stevo Pendarovskit si kandidat të tyre në zgjedhjet presidenciale.⁵ Më 4.3.2024 partnerët tradicionalë të koalicionit të LSDM-së e mbështetën kandidaturën e Stevo Pendarovskit për president të shtetit. Duke pasur parasysh faktin se Pendarovski njoftoi se bëhet fjalë për kandidaturë qytetare, kandidatura e tij u vërtetua edhe me mbledhjen e nënshkrimeve.

Deputetja dhe profesorja Gordana Siljanovska Davkova është kandidatë për presidentë e VMRO-DPMNE-së. Në konventën e partisë së mbajtur me datë 2.3.2024, Siljanovska Davkova u zgjodh kandidatë e VMRO-DPMNE-së në zgjedhjet e ardhshme presidenciale, me mbështetjen e 444 delegatëve.⁶ Siljanovska Davkova ishte kandidati i vetëm në konventën e partisë dhe me kandidaturën paraqiti planin, programin e punës dhe numrin e nevojshëm të nënshkrimeve të delegatëve. Kandidatura u vërtetua me nënshkrimet e mbledhura të qytetarëve, por të njëjtat nuk u dorëzuan në KSHZ.⁷

Ministri aktual i punëve të jashtme, Bujar Osmani është kandidati për president i BDI-së. Në konventën e mbajtur më 9 mars me moton „Koha për Presidentin e Parë

3 Gjendja e numrit të nënshkrimeve të mbledhura për kandidatët për President të shtetit, përfundimisht me 8 mars të vitit 2024, 20 h. <https://www.sec.mk/pretsedatelski-izbori-2024/#tab-id-9> (vizita e fundit 25.3.2024)

4 Kandidati për kryetar duhet të propozohet nga më së paku 10 000 votues (përmes mbledhjes së nënshkrimeve ose nga 30 deputetë).

5 LSDM e vërtetoi kandidaturën për president të Stevo Pendarovskit <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32846165.html> (vizita e fundit më 25.03.2023)

6 Gordana Siljanovska Davkova është zgjedhur si kandidat i VMRO-DPMNE-së për president <https://kanal5.com.mk/gordana-siljanovska-davkova-e-izbrana-za-kandidat-na-vmro-dpmne-za-pretsedatel/a628507> (vizita e fundit më 25.03.2023)

7 Kandidatura e Siljanovska - Davkovës në KSHZ është pa nënshkrimet e qytetarëve, për shkak se kjo gjë është një çështje protokollare – thonë nga VMRO-DPMNE <https://360stepeni.mk/kandidaturata-na-siljanovska-davkova-do-dik-e-bez-graganski-potpisi-zatoa-shto-toa-e-protokolarna-rabota-velat-od-vmro-dpmne/> (vizita e fundit më 25.03.2023)

Shqiptar“, BDI e promovoi kandidatin për president, Bujar Osmanin.⁸

Kryetari i Aleancës për Shqiptarët (AA) dhe kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Taravari, më 15 shkurt në konferencën e përbashkët për shtyp me liderët e Besës, Bilall Kasami, Alternativës, Afrim Gashi dhe Lëvizjes demokratike Izet Mexhiti, e bëri publike kandidaturën e tij për president të shtetit. Arben Taravari si kandidat për president i opozitës shqiptare, të bashkuar në koalicionin „Vlen“ u promovua më 2 mars në konventën në Gostivar.⁹ Kandidatura e Taravarit shkaktoi përçarje brendapartiake në AA dhe e hapi çështjen kush është kryetar legjitim i partisë. Ish-lideri i AA-së, Ziadin Sela, theksoi se organet e partisë nuk kanë marrë vendim që Taravari të jetë kandidat në zgjedhjet e ardhshme presidenciale dhe ka vepruar me iniciativën e tij në kundërshtim me qëndrimin e partisë në zgjedhjet të veprojë i pavarur. Më 16 shkurt, në kongresin e jashtëzakonshëm në të cilin morën pjesë 421 delegatë, krahu i Arben Taravarit e shkarkoi Ziadin Selën nga funksioni i kryetarit të Kryesisë qendrore dhe e rizgjodhi Taravarin lider të Aleancës për Shqiptarët. Krahu i Ziadin Selës në kongresin e jashtëzakonshëm më 18 shkurt e shkarkoi Arben Taravarin nga funksioni i kryetarit në parti, për shkak të një sërë shkeljesh të statutit të partisë dhe njëzëri, me 591 vota, e zgjodhi Ziadin Selën sërish në krye të partisë.¹⁰

Lidhur me atë se kush ka të drejtë të jetë në krye të partisë pritet zgjidhja ligjore, gjegjësisht vendimi i gjykatës në Tetovë.

Kryetari i komunës së Kumanovës dhe lideri i partisë ZNAM, Maksim Dimitrievski është kandidat për president të shtetit nga ky subjekt i ri politik në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, Kandidatura e Maksim Dimitrievskit u zyrtarizua në Kongresin e parë të partisë politike „Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë tonë“ që u mbajt më 22 shkurt në Shkup.¹¹

Profesorja Biljana Vankovska Cvetkovska nga Fakulteti filozofik në Shkup është candidate për presidente nga E Majta - Levica. Kandidatura e Biljana Vankovska Cvetkovskës u shpall zyrtarisht në konferencën për shtyp të partisë „Levica“ më 7 shkurt.¹²

8 Osmani edhe zyrtarisht promovohet si kandidat për president nga BDI <https://360stepeni.mk/osmani-i-ofitsijalno-promoviran-za-pretsedatelski-kandidat-na-dui-predizvitsite-se-golemi-bitno-e-da-bide-vistinskiot-chovek-na-vistinska-funksija/> (vizita e fundit më 25.03.2023)

9 Taravari i promovuar si kandidat për president i „Vlen“ mbajti Konventën në Gostivar <https://plusinfo.mk/taravari-promoviran-za-pretsedatelski-kandidat-vredi-odrzha-konvenci-a-vo-gostivar/> (vizita e fundit më 25.03.2023)

10 I shkarkuari Sela e ka shkarkuar Taravarin nga pozita e liderit në Aleancën për Shqiptarët? - <https://telma.com.mk/2024/02/18/razresheniot-sela-go-razreshi-taravari-od-liderskata-poziczija-vo-alijansa-za-albanczite/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

11 Kongresi i parë i ZNAM, kandidatura e zyrtarizuar për president e Maksim Dimitrievskit <https://a1on.mk/macedonia/prv-kongres-na-znam-oficializirana-pretsedatelskata-kandidatura-na-maksim-dimitrievski/> (vizita e fundit më 25.03.2023)

12 Biljana Vankovska - candidate për presidente E Majta - Levica <https://www.dw.com/mk/profesorkata-biljana-vankovska-vleguva-vo-trkata-za-pretsedatel-kako-kandidat-na-levica/a-68192357> (vizita e fundit më 25.03.2024)

Kryetari aktual i komunës së Karposhit dhe lideri i partisë GROM, Stevço Jakimovski, është kandidati për president nga partia për zgjedhjet e ardhshme. Në mbledhjen më 21 shkurt, Kuvendi qendror i GROM-it mori vendim që Stevço Jakimovski të jetë kandidati i partisë për president të shtetit.¹³

KSHZ në seancën më 22 mars i vërtetoi kandidaturat për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2024. Duke pasur parasysh se Listat e kandidatëve u parashtruan në përputhje me kushtet e përcaktuara ligjore dhe në afatin e paraparë ligjor, Komisioni i vërtetoi Listat e kandidatëve për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2024 sipas radhitjes së dorëzimit të tyre në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve.¹⁴

Fushata zgjedhore për zgjedhjet presidenciale të caktuara për 24 prill të këtij viti, fillon më 4 prill në orën 00:00 dhe do të zgjasë deri në orën 24:00 më 22 prill.

Zyra e OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) më 21 mars e hapi misionin vëzhgues në Maqedoninë e Veriut për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Për të dy ciklet zgjedhore do të angazhohen 320 vëzhgues, nga të cilët 20 afatgjatë dhe 300 afatshkurtër.¹⁵

Këto janë zgjedhjet e 22-ta në vend që do t'i vëzhgojë OSBE/ODIHR. Të fundit ishin zgjedhjet lokale në v. 2021 që u vëzhguan nga misioni.

Pas disa muajsh vlimesh politike lidhur me ndryshimet kushtetuese dhe kërkesat e intensifikuara të opozitës për zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare, mbajtja e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare u caktua më 4 dhjetor të vitit 2023 në takimin e liderëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend. Liderët politikë arritën marrëveshje me konsensus të gjerë që zgjedhjet parlamentare të mbahen më 8 maj, e mërkurë, së bashku me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Më herët, më 24 prill, gjithashtu të mërkurën, do të mbahet rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale. Data 8 maj ishte si datë e vetme e mundshme për t'u realizuar zgjedhjet parlamentare në kohën e caktuar të rregullt, ndërsa ato parlamentare të mbarojnë deri në mbarimin e mandatit të Stevo Pendarovskit më 12 maj. Përveç datave të zgjedhjeve, lideri i LSDM-së, Dimitar Kovaçevski dhe ai i VMRO-DPMNE-së,

13 Stevço Jakimovski, kandidat për president i GROM-it <https://24.mk/details/stevcho-jakimovski-kandidat-za-pretsedatel-na-grom> (vizita e fundit më 25.03.2024)

14 Njoftim i seancës së Tetëdhjetë e tetë të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve <https://www.sec.mk/izvestuvanje-od-osumdeset-i-osmata-sednica-na-drzhavnata-izborna-komisija-odrzhana-na-21-mart-2024-godina/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

15 OSBE/ODIHR e hapi misionin vëzhgues në Maqedoninë e Veriut <https://www.osce.org/mk/odihr/elections/565066> (vizita e fundit më 25.03.2024)

Hristijan Mickovski, kanë theksuar se në takimin e liderëve ka pasur edhe konsensus të gjerë për pranimin e vërejtjeve lidhur me Kodin zgjedhor nga OSBE/ODIHR. Në takimin e liderëve nuk u arrit marrëveshje për ndryshimet kushtetuese.¹⁶

Konform ligjit, më 28 janar, pra 100 ditë para zgjedhjeve u formua qeveria teknike (e Përzhinos). Kryeministri Dimitar Kovaçevski dhe kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi më 25 janar dorëzuan dorëheqjet. Kuvendi i Maqedonisë së Veriut me 65 vota „pro“ dhe tre „kundër“ votoi qeverinë teknike në krye me kryeministrin e parë shqiptar, Talat Xhaferi, nga BDI.¹⁷ Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti theksoi se është një ditë historike, ndërsa BDI-ja zgjedhjen e festuan me kollare të kuqe në të cilat shkruan Kryeministër – Shqiptar – 28.01.2024.¹⁸ Detyra themelore e qeverisë është që të organizojë zgjedhje parlamentare korrekte dhe demokratike. Partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, edhe pse i propozoi kandidatët e saj në qeveri, nuk votoi për zgjedhjen e saj, sepse kundërshtonte që qeveria të udhëhiqej nga Talat Xhaferi. Sipas përvojës së deritashme me qeveritë teknike, ky manovër politik ndodh për herën e dytë sepse në vitin 2016 LSDM-ja edhe pse propozuan ministra e lëshuan seancën dhe nuk votuan për Qeverinë teknike të udhëhequr nga Emill Dimitrev nga VMRO-DPMNE.¹⁹ Kjo është qeveria e tretë kalimtare ose teknike që viti 2016.

Presidenti aktual, Stevo Pendarovski dhe kandidatja e partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE, Gordana Siljanovska - Davkova kandidohen sërish në këto zgjedhje, ndërsa trupi votues shqiptar do të ketë mundësi që të votojë edhe për dy kandidatët shqiptarë për presidentin e shtetit. Në drejtim të forcimit të pozitave të veta para zgjedhjeve, partitë politike shqiptare e aktualizuan kërkesën për zgjedhjen e presidentit në kuvend, por partitë politike më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM theksuan se janë kundër heqjes së zgjedhjeve të drejtpërdrejta për president dhe zgjedhjes konsensuale të kryeshefit të shtetit në Kuvend.²⁰

Edhe pse në prag të zgjedhjeve presidenciale paralajmërohej se edhe në këto zgjedhje LSDM dhe BDI do të shkojnë me kandidat të përbashkët presidencial, respektivisht se Stevo Pendarovski edhe në këto zgjedhje do të jetë kandidat konsensual,

16 Marrëveshje e arritur për zgjedhjet: Më 24 prill presidenciale, ndërsa më 8 maj parlamentare me rreth ty dytë presidenciale <https://360stepeni.mk/postignat-dogovor-za-izborite-na-24-april-pretsedatelski-a-na-8-maj-parlamentarni-so-vtor-krug-pretsedatelski/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

17 Është zgjedhur qeveria teknike në krye me Xhaferin <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32795231.html> (vizita e fundit më 25.03.2024)

18 BDI e feston zgjedhjen e Xhaferit për kryeministër teknik me kollare të kuqe <https://360stepeni.mk/dui-goslavi-izborot-na-dhaferi-za-tehnicki-premier-so-tsrvni-vratovski/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

19 Në vitin 2016 LSDM nuk votoi për Qeverinë teknike <https://alsat.mk/mk/vo-2016-godina-sdsm-neglasashe-za-tehnickata-vlada/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

20 Pro dhe kundër zgjedhjes së presidentit në Kuvend <https://telma.com.mk/2024/02/24/za-i-protiv-izborot-na-pretsedatel-vo-sobranie/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

megjithatë BDI vendosi të shkojë në zgjedhje me kandidatin e vet.²¹

Arsyet e këtij vendimi në masë të madhe kanë të bëjnë me faktin se opozita e bashkuar shqiptare në këto zgjedhje doli me kandidat të përbashkët për president, por edhe mosmarrëveshjet në prag të zgjedhjeve ndërmjet BDI-së dhe presidentit Pendarovski lidhur me Ligjin për lojërat e fatit.²²

Mosmarrëveshjet politike dhe akuzat e ndërsjella rrodhën që kur presidenti Pendarovski nuk e nënshkroi Ligjin për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese dhe tha se një gjë të tillë e ka bërë për shkak të indikacioneve serioze të BE-së se flamuri evropian po keqpërdoret.²³

Për dallim nga zgjedhjet e mëparshme presidenciale të mbajtura në vitin 2019 kur kishte tre kandidatë, në këto zgjedhje ka shtatë kandidatë presidencialë, që do të kontribuojë në polarizimin e fuqishëm politik në periudhën e ardhshme, e për shkak të garës së pasigurt zgjedhore mund të priten fushata parazgjedhore të përqendruara në diskreditimin e kundërshtarëve. Mbivendosja e fushatave parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare do të shfrytëzohet në mënyrë plotësuese për ashpërsimin e retorikës politike në drejtim të forcimit të pozitave të kandidatëve për president.

Në këtë kontekst, OSBE/ODIHR në raportin e tij për ambientin parazgjedhor paralajmëroi për paqëndrueshmëri të mundshme dhe zgjedhje të pasigurta. Gjithash-tu, shprehet shqetësimi për keqpërdorimin e mundshëm të burimeve shtetërore dhe presioni ndaj punonjësve në sektorin publik, si dhe për retorikën jotoleruese që e përkeqëson ambientin e tensionuar politik. Në raport përmendet se shtrirja mediatike e fushatës zgjedhore është e fragmentuar dhe e polarizuar, ka rritje të konsiderueshme të retorikës nacionaliste që mund të rezultojë në shtimin e trazirave dhe tensioneve, është vërejtur rritje të retorikës së patolerueshme dhe të dhunshme e cila mund të interpretohet edhe si gjuhë e urrejtjes.²⁴

Stejt departamenti i SHBA-ve më 18 mars njoftoi se kryetari i komunës së Karposhit dhe kandidati për president në zgjedhjet e ardhshme Stevço Jakimovski është vënë

21 BDI vendosi ta ketë kandidatin e vet në zgjedhjet presidenciale <https://kanal5.com.mk/dui-odluchi-da-ima-soj-kandidat-na-pretседателskite-izbori/a364404> (vizita e fundit më 25.03.2024)

22 BDI kundër Pendarovskit: E nënshkroi Kodin penal me flamur evropian, edhe pse BE e kundërshtonte <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32820714.html> (vizita e fundit më 25.03.2024)

23 Presidenti Pendarovski nuk e nënshkroi Dekretin për shpalljen e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërave argëtuese https://pretsedatel.mk/dopis_13022024/ (vizita e fundit më 25.03.2024)

24 BDI kundër VLEN-it: Kush po përgatit krizë politike? <https://telma.com.mk/2024/03/14/dui-kontra-vredikoj-podgotvuva-politichka-kriza/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

në listën e zezë, për shkak të veprimtarive korruptive me të cilat rrënohet sundimi i ligjit dhe besimi i opinionit publik në institucionet demokratike.²⁵ Kandidati Stevço Jakimovski u përgjigj se bëhet fjalë për një gjë të pandershme që po ndodh për shkak të kandidaturës së tij dhe tentim për ndërhyrje në procesin zgjedhor.²⁶

Duke pasur parasysh faktin se më 8 maj mbahen zgjedhjet parlamentare, rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të kontribuojë padyshim në pozicionimin politik dhe në mobilizimin e anëtarësisë së partive politike në prag të zgjedhjeve parlamentare. Rezultatet e rrethit të parë do t'i përcaktojnë konstelacionet e mëtejshme politike dhe do të çojnë në negociata të theksuara politike ndërpartiake në prag të zgjedhjeve parlamentare dhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Përgatitjet për zgjedhjet presidenciale

Më 14 shkurt KSHZ-ja miratoi Kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për President.²⁷ Në kuadër të aktiviteteve përgatitore, KSHZ-ja vazhdimisht i plotëson komisionet komunale zgjedhore (KKZ) me anëtarë në vendet e atyre që u ka përfunduar mandati ose nuk ka pasur kërkesa për shkarkim, por jo më vonë se 26 mars. Sipas Kalendarit të afateve, Komisioni komunal zgjedhor (KKZ) duhet t'i formojë këshillat zgjedhorë (KZ-të) më së voni deri më 26 mars, ndërsa deri në atë datë KSHZ-ja duhet t'i formojë edhe KZ-të në PDK-të.

Shikimi publik i listës zgjedhore në njësitë rajonale të KSHZ-së, në faqen e uebit <http://izbirackispisok.gov.mk/>, si dhe në PDK-të (për votim jashtë shtetit) u hap në periudhën 28 shkurt - 18 mars 2024. Ata qytetarë të cilët gjatë kësaj periudhë konstatojnë se nuk ndodhen në Listën zgjedhore, ndërsa i plotësojnë kushtet për të drejtën e votës, mund të kërkojnë të regjistrohen. Në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në mbylljen e shikimit publik të Listës zgjedhore, shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë jashtë shtetit dhe të cilët i plotësojnë kushtet për votim jashtë shtetit mund të paraqiteshin që ta realizojnë këtë të drejtë të tyre.

25 SHBA-të vendosën Katica Janevën dhe Stevço Jakimovskin në listën e zezë <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32866680.html> (vizita e fundit më 25.03.2024)

26 Jakimovski për listën e zezë: Jam i habitur, kjo është një gjë e pandershme <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32867504.html> (vizita e fundit më 25.03.2024)

27 Kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për Presidentin e shtetit 2024 - https://drive.google.com/file/d/1iN8Gim1W542gkDasz_aDHK0pX_43dEcZ/view (vizita e fundit më 25.03.2024)

Listën zgjedhore, në të cilën janë bërë të gjitha ndryshimet e dala nga shikimi publik, të publikuar në formë ekstraktesh, KSHZ-ja e mbyll më së voni 15 ditë pas mbarimit të shikimit publik, më së voni deri më 2 prill. KSHZ-ja e nënshkruan Listën zgjedhore të përmbyllur, gjegjësisht ekstraktet e Listës zgjedhore në të cilat votohet, më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, më së voni më 8 prill.

Sipas kalendarit të afateve, raportet financiare (me specifikacion të shpenzimeve për të ardhurat dhe harxhimet në llogarinë e transaksionit) të organizatorëve të fushatës zgjedhore në KSHZ, Entin shtetëror të revizionit (ESHR) dhe Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) dorëzohen në afatet e mëposhtme:

- » më 12 maj për të ardhurat dhe harxhimet e fushatës së rrethit të parë, nëse nuk mbahet rrethi i dytë i votimit ose më 26 maj nëse mbahet rrethi i dytë, për të ardhurat dhe harxhimet e pjesës së dytë të fushatës zgjedhore;
- » raporti i përgjithshëm financiar dorëzohet më së voni në afat prej 15 ditëve pas mbylljes së llogarive të transaksionit dhe parashtrohet në KSHZ, ESHR, KSHPK dhe në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (internet portal-et) e kanë për detyrë të parashtrorjnë raport në Ministrinë e financave (MF), KSHZ, ESHR dhe KSHPK, për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, më së voni deri më 7 maj nëse nuk mbahet rrethi i dytë, ndërsa më së voni deri më 21 maj nëse mbahet rrethi i dytë i votimit.

Në pajtim me nenin 8-a të Kodit zgjedhor, 20 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore filloi periudha në të cilën nuk mund të mbahen ngjarjet publike me rastin e nisjes së ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objektit ose të infrastrukturës të financuar nga mjetet e Buxhetit, fondet publike, si dhe mjetet e ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror.²⁸

Me dispozitën kalimtare nga ndryshimet e Kodit zgjedhor e cila do të zbatohet vetëm për zgjedhjet në vitin 2024, zgjedhësit mund të votojnë me letërnjoftim ose me dokument udhëtimi vlefshmëria e të cilit ka skaduar në periudhën prej 9 muajve deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Në zgjedhjet presidenciale mund të votojnë qytetarët të cilëve në çfarëdolloj baze u kanë skaduar dokumentet personale nga data 24.7.2023 deri në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht deri në datën 24.4.2024.²⁹

28 Kodi zgjedhor <https://drive.google.com/file/d/1ZJMruqcNI-yC5VuWSzpFT9BFekPhm5An/view> (vizita e fundit më 25.03.2024)

29 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve mbajti brifing me gazetarët <https://www.sec.mk/drzhavnata-izborna-komisija-odrza-brifing-so-novinari/> (vizita e fundit më 25.03.2024)

Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor

Prej zgjedhjes së fundit të presidentit të shtetit, deri më sot, janë bërë më shumë ndryshime lidhur me dispozitat e Kodit zgjedhor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV). Kuvendi në mars të këtij viti, me procedurë të shkurtuar dhe me 84 vota „pro“ i sollti ndryshimet e reja në Kodin zgjedhor. Ndryshimet kanë të bëjnë me organet shtetërore zgjedhore, me financimin e fushatës politike, me pjesëmarrësit në fushatë, si dhe me shtrirjen mediatike të fushatës zgjedhore.³⁰

Për shkak të situatës së re të krijuar me vlefshmërinë e dokumenteve personale të qytetarëve, ekzistonte rreziku i madh që mbi 100.000 qytetarë të mos kenë të drejtën e votës në zgjedhjet e ardhme. Me propozimin e KSHZ-së, në ndryshimet e Kodit zgjedhor është gjetur dispozita kalimtare që rregullon të drejtën e zgjedhësit për të votuar me letërnjoftim ose dokument udhëtimi të cilit i ka skaduar vlefshmëria në periudhën prej nëntë muajsh deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, gjegjësisht parlamentare.³¹

Si plotësim, u përcaktuan dispozitat lidhur me regjistrimin e votuesve të rinj dhe me të drejtën e votës do të pajisen të gjithë ata që përfundimisht me ditën e zgjedhjeve do të mbushin 18 vjet. Kjo domethënë se qytetarët që do të kalojnë në moshë madhore ndërmjet dy cikleve zgjedhore, do të kenë të drejtën e votës vetëm në zgjedhjet parlamentare.³²

Tre ditë para fillimit të fushatës për zgjedhjet presidenciale, deputetët e sollën njëzëri Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor me të cilin përcaktohen dispozitat për përcaktimin e numrit rendor të fletëvotimit për dy proceset zgjedhore, gjegjësisht partitë politike që propozuan ose mbështetën një kandidat për president të shtetit, mund të ruajnë numrat rendorë të tërhequr edhe për zgjedhjet parlamentare për një prezantim më të thjeshtë para qytetarëve. Partitë politike që nuk kanë kandidat të tyre për president, por do të marrin pjesë në zgjedhjen e deputetëve, në mënyrë plotësuese, me anë të shortit në KSHZ do t'i tërheqin numrat rendorë me të cilët do të paraqiten në zgjedhje.³³

30 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor 58/2024

31 „Mbi 100.000 qytetarë nuk kanë dokumente për votim në zgjedhje, KSHZ-ja propozoi ndryshime të Kodit zgjedhor, Kuvendi e ka rradhën“ Tellma, 4 mars 2024. Në dispozicion në <https://telma.com.mk/2024/03/04/nad-100-000-gragani-nemaat-dokumenti-za-glasane-na-izbori-sobraniето-na-potegu-otkako-dik-predlozhi-izmeni-na-izborniot-zakonik/> (vizita e fundit: 27 mars 2024)

32 „KSHZ: Qytetarët që do të mbushin 18 vjet ndërmjet dy rretheve të zgjedhjeve presidenciale më 8 maj do të mund të votojnë vetëm për zgjedhjen e deputetëve“ 360 shkallë, 15 mars 2024. Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/dik-graganite-shto-ke-napolnat-18-godini-pomegu-dvata-kruga-na-pretседателските-izbori-na-8-maj-ke-mozhe-da-glasaat-samo-za-izbor-na-pratenitsi/> (vizita e fundit: 26 mars 2024)

33 „Sot përfundon afati për parashtrimin e listave për deputetë, përfundohet edhe Lista zgjedhore“ 360 shkallë, 2 prill 2024. Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/deneska-zavrshuva-rokot-za-prijavuvane-na-listite-za-pratenitsi-se-zakluchuva-i-izbirachkiot-spisok/> (vizita e fundit: 2 prill 2024)

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

Anëtar i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve mund të zgjidhet personi i cili është shtetas i RMV-së me vendbanim të përhershëm në vend, të ketë arsim të lartë me të paktën tetë vjet përvojë pune dhe të mos jetë anëtar i ndonjë organi të partisë politike. Kuvendi i RMV-së në afat 30 ditësh para mbarimit të mandatit të Komisionit e shpall Konkursin për zgjedhje të përbërjes së re, përkatësisht zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të KSHZ-së në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në shtypin ditor. Shpallja zgjat tetë ditë nga dita e shpalljes në Gazetën zyrtare.

Procedura për zgjedhjen e anëtarëve mbetet e njëjtë dhe përgatitet dhe zbatohet nga Komisioni për çështjen e zgjedhjeve dhe emërimeve në kuadër të Kuvendit të RMV-së. Ky komision përgatit propozim të listës së kandidatëve të paraqitur dhe e dorëzon në Kuvend. Nga kandidatët e listës së propozuar, opozita propozon kryetarin dhe dy anëtarët, ndërsa partitë në pushtet propozojnë nënkryetarin dhe tre anëtarët. Të gjithë anëtarët zgjidhen me dy të tretat e shumicës nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Me ndërhyrjen e bërë në Kodin zgjedhor në shtator të vitit 2021, u ndryshuan disa nene që e rregullojnë zgjedhjen, mandatin dhe punën e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Me ndryshimin e nenit 26, mandati i anëtarëve të Komisionit shtohet në pesë vjet nga dita e zgjedhjes. Si plotësim, ndryshimet në nenet 27, 29 dhe 30 e rregullojnë për herë të parë procesin e riorganizimit të përbërjes së Komisionit në rast të ndërrimit të pushtetit, si dhe të zgjedhjes së anëtarëve të rinj dhe të Sekretarit të përgjithshëm.³⁴

Ndryshimet e Kodit zgjedhor të këtij viti e obligojnë Komisionin shtetëror të zgjedhjeve që të formojë Qendrën e edukimit të vazhdueshëm në zgjedhje, si njësi e veçantë organizative në shërbimin e saj, me të cilën do të udhëheqë këshilltari shtetëror i nivelit B1³⁵, i cili përgjigjet para Komisionit dhe Sekretarit të përgjithshëm. Qendra do të ketë për qëllim që të sigurojë trajnimin e vazhdueshëm të administratës zgjedhore, të votuesve, të pjesëmarrësve në zgjedhje, të mediave dhe të vëzhguesve zgjedhorë, si dhe të përpunojë hulumtime dhe analiza të ndryshme për nevojat dhe me kërkesë të KSHZ-së.³⁶

34 5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor 218/2021

35 Sipas Nenit 24 të Ligjit për nëpunësit administrativë, nëpunësi shtetëror i kategorisë B1 është nëpunësi udhëheqës administrativ i nivelit të parë, i cili i plotëson kushtet duke pasur të paktën dy vjet përvojë pune në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, gjegjësisht të paktën tre vjet në pozitë udhëheqëse në sektorin privat.

36 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor 58/2024

Financimi i partive politike

Ligji për financimin e partive politike nuk ka pësuar ndryshime vitet e fundit. Mbeten të vlejshme dispozitat që kanë të bëjnë me specifikimin e pronës dhe financimin e partive politike (pronë e luajtshme dhe paluajtshme), lartësinë e mjeteve të përgjithshme për financimin vjetor të partive politike në lartësi prej 0,15% e të ardhurave të përgjithshme burimore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, burimet private të financimit, lartësinë e donacioneve të veçanta që nuk guxojnë të tejkalojnë shumën e 60 pagave mesatare si donacion nga personat juridikë dhe 30 pagave mesatare neto nëse është donacion nga personat fizikë. Me ndryshimet e fundit të Kodit zgjedhor, në mars të vitit 2024, nenit 83 iu shtua paragrafi i ri që i rregullon donacionet e veçanta që i marrin partitë politike për fushatat zgjedhore. Me fjalë të tjera, shuma e mjeteve kumulative në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore nuk guxon të jetë më e madhe se 3.000 euro në kundërvlerë denari nga personi i njëjte fizik ose 30.000 euro në kundërvlerë denari nga personi i njëjte juridik.

Mjetet për financimin e partive politike, në shumë prej 30% që sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe më tej shpërndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partitë politike që kanë fituar më së paku 1% nga numri i përgjithshëm i votave nga zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale. 70% e mjeteve u shpërndahen partive politike sipas numrit të deputetëve të zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe sipas numrit të zgjedhur për këshilltarë në zgjedhjet e fundit lokale.

Neni 26 i Ligjit për financimin e partive politike parasheh që mbikëqyrjen e financimit ta kryejë Enti shtetëror i revizionit. Neni, po ashtu parashikon që partitë duhet të kenë vetëm një xhironlogari, e në rastet e financimit nëpërmjet sigurimit të mjeteve kreditore nga bankat komerciale, krahas xhironlogarisë bazë, mund të kenë edhe një xhironlogari të veçantë për fondet e partisë të siguruara përmes kredisë. Gjithashtu, partia politike ka të drejtë të transferojë mjete ndërmjet llogarive të saj, ndërsa qendrat e partive për hulumtime dhe analizë kanë llogari të veçantë. Mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në lartësi prej 280.000 euro në kundërvlerë denari, janë paraparë edhe për financimin vjetor të qendrave hulumtuese dhe analitike të partive, të formuara konform ligjit si pjesë e organizimit të brendshëm të partisë.³⁷

³⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike, 140/2018

Me ndryshimet e ligjit në v. 2018, u bë i detyrueshëm dorëzimi i raportit financiar për punët materiale-financiare të partisë i cili e përmban punën financiare të llogarisë, respektivisht faturat e partisë politike. Me ndryshimet, si pjesë plotësuese e raportit financiar, njihen zërat „sponzorizim“ dhe „kredi“. Këto ndryshime parashikonin që mjetet e dedikuara për financimin e partive politike të shlyhen në përputhje me mundësitë buxhetore, por jo më vonë se 1 mars në çdo vit rrjedhës.

Mediat publike

Edhe këtë cikël zgjedhor do të vlejë ndalesa e ndryshimeve të Kodit zgjedhor në vitin 2018 me të cilën nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, deri në fillimin e fushatës zgjedhore, radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet) nuk guxojnë të emetojnë, respektivisht të publikojnë reklamim të paguar politik, përveç shpalljeve dhe njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturës së grupit të zgjedhësve. Në rastet kur bëhet fjalë për emetim, respektivisht publikim të njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturave, kjo bëhet në blloqe të shënuara reklamuese gjatë kohës së lejuar të reklamimit brenda një ore reale. Ndryshmet në Kodin zgjedhor nga marsi i vitit 2024, në anën tjetër, parashikojnë kufizime në promovimin e kandidatëve, respektivisht nga momenti i përcaktimit të listave të kandidatëve deri te fillimi i fushatës zgjedhore, pjesëmarrësit në zgjedhjet kanë të drejtën që të organizojnë nga një ngjarje publike për promovimin e listave të tyre tashmë të vërtetuara të kandidatit/kandidatëve dhe të programeve zgjedhore. Rrjedhimisht, me nenin 69-a u ndalohet partive të shpenzojnë mjete të dedikuara për fushatën zgjedhore në periudhën e përmendur më parë.

Gjatë rrethit të parë dhe të dytë të fushatës zgjedhore, radiodifuzerët që mbulojnë zgjedhjet, mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta kohë reale të dedikuara vetëm për reklamim të paguar politik. Nga këto 9 minuta, gjithsej katër minuta mund të ndahen për partitë politike të pushtetit, katër minuta për partitë politike të opozitës, ndërsa një minutë për grupin e deputetëve ose partitë politike që nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këtë vit, për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të dyfishta, ka mundësi në një orë të dhënë partitë të reklamohen gjithsej 19 minuta. Më parë, rast të këtillë kishte në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e dyfishta në v. 2014 kur partitë u morën vesh për kufizimin 15 minutësh promovion në një orë.³⁸

38 „Zgjedhjet 2024: MEP-i partiak i përmasave epike“, Prizma, 8 shkurt 2024. Në dsipozicion në: <https://prizma.mk/izbori-2024-partisko-epp-od-epski-razmeri/> (vizita e fundit: 26 mars 2024)

Me ndryshimet e Kodit zgjedhor në v. 2021 në vend të Ministrisë së financave, detyrimi për shlyerjen e shpenzimeve në bazë të faturës për reklamimin e publikuar politik me pagesë të radiodifuzerëve, mediave të shtypit dhe mediave elektronike i delegohet Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Bashkëngjitur me faturën e dorëzuar, mediat dorëzojnë media planin, si dhe Raportin për shërbimet e realizuara që janë vërtetuar nga radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet) dhe nga pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore.

Me ndryshimet më të reja në Kodin zgjedhor, shërbimi radiodifuziv publik, si dhe stacionet televizive që do të publikojnë reklamim të paguar politik, janë të obliguara që t'i publikojnë përmbajtjet lidhur me procesin zgjedhor në format me qasje për personat me aftësi të kufizuara, gjegjësisht me përdorimin e gjuhës së shenjave, të titrave, të audio përshkrimit ose të mjeteve të tjera për sigurimin e qasjes, të paktën një herë, në periudhën prej orës 16:00 deri në orën 24:00. Si plotësim, neni 75 i obligon ofruesit e shërbimeve, që para fillimit të fushatës zgjedhore, të dorëzojnë orarin në Agjencinë për shërbime audio dhe audio-vizuale (ASHMAA) se cilat edicione të lajmeve dhe cilat përmbajtje do t'i emetojnë në format me qasje për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa ASHMAA duhet ta publikojë të njëjtën në faqen e saj të internetit.



**Historiku i zgjedhjeve
presidenciale në Republikën
e Maqedonisë së Veriut
(1991 – 2019)**

1. Historiku i zgjedhjeve presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1991 – 2019)

Presidenti i parë i Maqedonisë së pavarur ishte Kiro Gligorov, i zgjedhur me votim të fshehtë në Kuvendin e Maqedonisë më 27 janar të vitit 1991, me 114 vota deputetësh „PRO“. Të gjitha zgjedhjet vijuese për president u zhvilluan në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta. Në zgjedhjet e para të tilla në vitin 1994, presidenti i atëhershëm Gligorov e fitoi mandatin e tij të dytë të njëpasnjëshëm. Gligorovi është i vetmi deri tani i cili arriti të fitojë në rrethin e parë zgjedhor. Në zgjedhjet e dyta të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta në vitin 1999 në garën presidenciale hynë gjashtë kandidatë, ndërsa fitoren në rrethin e dytë e korri kandidati i VMRO-DPMNE-së, Boris Trajkovski. Ai detyrën e Presidentit e kreu deri në vdekjen e tij tragjike në vitin 2004. Në zgjedhjet e parakohshme presidenciale në vitin 2004, për Presidentin e tretë i Republikës së Maqedonisë u zgjodh kandidati i LSDM-së, Branko Cërvenkovski. Në katër zgjedhjet presidenciale në vitin 2009 Gjorgje Ivanov e fitoi mandatin e tij të parë, ndërsa mandatin e tij të dytë e siguroi në zgjedhjet në vitin 2014 kur në rrethin e dytë e fitoi presidentin aktual Stevo Pendarovski.



Stevo Pendarovski, president i pestë i RMV-së (2019-2024)

Më shumë informacion për historikun e zgjedhjeve presidenciale nga pavarësia deri më sot mund të gjeni në Doracakun për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019.³⁹

Presidenti aktual i Republikës, Stevo Pendarovski, në përpjekjen e tij ty dytë arriti ta fitojë vendin në kabinetin presidencial pas fitores në dy rrethet zgjedhore në zgjedhjet e gjashta presidenciale. Në garën presidenciale në vitin 2019 morën pjesë tre kandidatë: Stevo Pendarovski, kandidati i LSDM-së me mbështetjen e BDI-së, Gordana Siljanovska Davkova, kandidate e VMRO-DPMNE-së, dhe Bler-

³⁹ Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në v. 2019, botim i dytë i plotësuar. KAS dhe IDSCS, v. 2019. F. 17-22. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf (vizita e fundit: 28 mars 2024)

im Reka i cili garoi si kandidat i pavarur, por i mbështetur nga Aleanca për Shqiptarët dhe BESA.

Në rrethin e parë zgjedhor më 21 prill të vitit 2019, të drejtën e votës e shfrytëzuan 753.556 qytetarë, gjegjësisht 41,68% të votuesve të regjistruar. Pas numërimit të votave, Pendarovski mori 42,81% të votave, gjegjësisht 322.581, Siljanovska Davkova mori 318.341 që është 42,25% e votave dhe kandidati Blerim Reka me 79.888, gjegjësisht 10,60% nga numri i përgjithshëm i votave. Vend në rrethin e dytë i cili u mbajt më 5 maj 2019 siguruan kandidatët e mbështetur nga LSDM-ja dhe VM-RO-DPMNE-ja. Fitues i zgjedhjeve në rrethin e dytë ishte presidenti aktual, Stevo Pendarovski, i cili kishte 51,65% (435.656 vota), ndërsa kundërkandidatja e tij, Gordana Siljanovska Davkova kishte 44,75% (377,446 vota). Dalja e qytetarëve në rrethin e dytë zgjedhor ishte 46,65%, gjegjësisht 843.508 votues.⁴⁰

40 Maqedoni e Veriut, zgjedhje presidenciale, 21 prill dhe 5 maj 2019: Raport final i misionit vëzhgues i ODHR, 21 gusht 2019. Në dispozicion në: https://www.osce.org/files/f/documents/5/3/428867_0.pdf (vizita e fundit: 27 mars 2024)

2

Sistemi zgjedhor i Maqedonisë për zgjedhjet presidenciale

2. Sistemi zgjedhor i Maqedonisë për zgjedhjet presidenciale

Presidenti i Republikës zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë së paku dy mandate. Zgjedhja e tij është e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kodin zgjedhor. Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përfaqësitë e saj diplomatike-konsullore, si një njësi zgjedhore sipas sistemit zgjedhor të shumicës. Të drejtën për t'u zgjedhur e ka çdo shtetas i Maqedonisë i cili në ditën e zgjedhjeve ka mbushur 40 vjet moshë dhe është banor i vendit më së paku dhjetë në 15 vitet e fundit. Kandidat për president mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose më së paku 30 deputetë.⁴¹

Zgjedhja e Presidentit pothuajse çdo herë kryhet në dy rrethe zgjedhore. Në rrethin e parë fitues është kandidati i cili do ta fitojë shumicën (50%+1 votues) e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në Listën zgjedhore. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk e arrin shumicën e kërkuar, në afat prej 14 ditëve zbatohet rrethi i dytë i votimit në të cilin hyjnë dy kandidatë me më së shumti vota në rrethin e parë. Në rrethin e dytë do të zgjidhet kandidati i cili e ka marrë shumicën e numrit të përgjithshëm të votave, me ç'gjë është e nevojshme 40% e votuesve të regjistruar ta kenë realizuar të drejtën e tyre të votimit. Nëse asnjë nga kandidatët nuk i përm-bush të dyja kushtet, e gjithë procedura zgjedhore përsëritet.⁴²

Numri i vendvotimeve në vend për zgjedhjet presidenciale të këtij viti është 3480, ndërsa për votim jashtë vendit janë paraparë 31 vendvotime në përfaqësitë diplomatike - konsullore. Votimi i diasporës zbatohet vetëm te përfaqësitë ku janë të paraqitur së paku dhjetë shtetas të Maqedonisë.⁴³ Fushata zgjedhore për zgjedhjen e presidentit fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe zgjat deri në një ditë para zgjedhjeve. Fushata për zgjedhjet presidenciale në vitin 2024 fillon më 4 prill në orën

41 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr.52/1991, e ndryshuar me Amendamente I-XXXVI.

42 Ibid

43 „Gjithsej 2.571 qytetarë jashtë shtetit do të mund të votojnë në zgjedhjet presidenciale“ Radio Evropa e Lirë, 27 mars 2024. Në dispozicion në <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32880067.html> (vizita e fundit: 28 mars 2024)

00:00 dhe mbaron në orën 24:00 më 22 prill, kur në fakt fillon heshtja zgjedhore.⁴⁴

Me marrjen e detyrës presidenti merr një sërë kompetencash dhe të drejtash ekskluzive. Ai e trashëgon mandatin për ta përfaqësuar Republikën brenda dhe jashtë shtetit, është komandant suprem i forcave të armatosura, dorëzon mandatin për përbërjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, emëron dhe shkarkon me dekret ambasadorët dhe të dërguarit e posaçëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë shtetit, pranon letrat kredenciale të përfaqësuesve të huaj diplomatikë në vend, propozon dy gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, dy anëtarë të Këshillit gjyqësor republikan, tre anëtarë të Këshillit për siguri dhe emëron dhe shkarkon bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjet. Si plotësim, jep dekorime dhe tituj nderi, jep falje në pajtim me ligjin dhe kryen funksione tjera që përcaktohen me Kushtetutën e shtetit. Detyra e Presidentit të Republikës nuk pajtohet me ushtrimin e funksionit, profesionit tjetër publik ose funksionit në parti politike. Presidenti gëzon imunitet gjatë kryerjes së funksionit të tij, por nëse shkel Kushtetutën dhe ligjet duhet të mbajë përgjegjësi. Procedurën për përcaktimin e përgjegjësive së këtyre e nis Kuvendi me dy të tretat e shumicës së votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Për përgjegjësinë e Presidentit vendos Gjykata kushtetuese me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i gjykatësve.

Sipas Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve është kompetent për ligjshmërinë, përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve, por edhe për mbikëqyrjen e punës së organeve zgjedhore. Në kompetencat e KSHZ-së hyn edhe shpallja e Listës zgjedhore e cila duhet të vihet në shqyrtim publik të qytetarëve, në afat 15 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Shqyrtimi publik i Listës zgjedhore zgjat 20 ditë. Krahas Komisionit dhe përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesve të listave, të drejtën e vëzhgimit të zgjedhjeve e kanë të gjitha organizata vendore dhe të huaja që kanë akreditim nga KSHZ-ja.

Më shumë informacion lidhur me sistemin zgjedhor dhe fushatën, rolin e mediave publike, si dhe për mandatin e presidentit mund të gjeni në Doracakun për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019.⁴⁵

44 „Fushata zgjedhore për zgjedhjet presidenciale nga 4 deri më 22 prill, për zgjedhjet parlamentare nga 18 prill deri më 6 shkurt. Në dispozicion në: <https://a1on.mk/macedonia/izbornata-kampanja-za-pretседателскиете-избори-од-4-до-22-април-за-парламентарните-од-18-април-до-6-мај/> (vizita e fundit: 28 mars 2024)

45 Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019, botimi i dytë i plotësuar. KAS dhe IDSCS, v. 2019 . F. 23-36. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf (vizita e fundit: 28 mars 2024)



3

**Pjesëmarrësit në zgjedhjet
presidenciale 2024**

3. Pjesëmarrësit në zgjedhjet presidenciale 2024⁴⁶

Stevo Pendarovski



Stevo Pendarovski është aktualisht President i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i zgjedhur në zgjedhjet presidenciale në vitin 2019. Para marrjes së funksionit të Presidentit ka qenë profesor në fakultetin e shkencave politike pranë Universitetit „Kolegji amerikan“ në Shkup (UAKS), ku ka ligjruar lëndët: Siguria ndërkombëtare, Marrëdhëniet ndërkombëtare, Hyrje në politikë, Globalizimi, Gjeopolitika, Politika ndërkombëtare e SHBA-ve, Politika ndërkombëtare dhe e sigurisë së BE-së dhe Shtetet e vogla në politikën botërore. Diplomoi në vitin 1987 në Fakultetin e drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi

“ në Shkup, ndërsa studimet e magjistraturës dhe të doktoraturës i mbaroi në Institutin për hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike në Shkup. Kjo është kandidatura e tretë presidenciale e Pendarovskit, i cili në zgjedhjet presidenciale në vitin 2014 humbi nga Gjorgje Ivanov në rrethin e dytë të votimit. Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2019 paraqitet si kandidat i përbashkët i LSDM-së, BDI-së dhe të 29 partive politike tjera.⁴⁷

Magjistroi në temën „Gjeopolitika e re e Republikës së Maqedonisë: Kontradiktat e matricave komuniste dhe tranzicionale“, ndërsa doktoroi në temën „Politika e jashtme dhe e sigurisë së BE-së dhe shtetet e vogla: korniza e diskursit nacional“.⁴⁸

Në periudhën 2001 – 2004 Stevo Pendarovski ishte këshilltar për siguri nacionale në Kabinetin e presidentit Boris Trajkovski, ndërsa në periudhën 2005 – 2009 ka mbajtur postin e këshilltarit për politikë të jashtme në Kabinetin e presidentit Branko Cërvenkovski. Ka qenë edhe kryetar i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve,

46 Kandidatët radhiten sipas Listës së vetme të përcaktuar të kandidatit për president të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve e miratuar me short më 25.3.2024. Fotografitë e pjesëmarrësve janë të shkarkuara nga profilet e tyre oficiale të Facebook-ut

47 Doracak për zgjedhjet presidenciale 2019. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf (vizita e fundit: 20.3.2024).

48 Doracak për zgjedhjet presidenciale 2014. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf (vizita e fundit: 4.3.2019).

në periudhën 2004 – 2005. Më parë, prej vitit 1998 deri në vitin 2001, ka punuar si ndihmës-ministër në Ministrinë e punëve të brendshme dhe si drejtues i Drejtorisë për analitikë dhe hulumtime në kuadër të Ministrisë. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 Stevo Pendarovski u zgjodh deputet në Kuvendin e Maqedonisë, ndërsa në nëntor të vitit 2017 u emërua koordinator nacional për përgatitjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në NATO.⁴⁹

Ai është autor i disa librave dhe punimeve shkencore të botuara në vend dhe më gjerë, si dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore, debate publike dhe diskutime.

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 do të paraqitet si kandidat i koalicionit të udhëhequr nga LSDM.⁵⁰

Stevo Pendarovski lindi më 3 prill 1963 në Shkup, i martuar dhe ka një fëmijë.

Gordana Siljanovska Davkova



Gordana Siljanovska Davkova është profesoreshë ordinare në pension e të Drejtës kushtetuese dhe Sistem politik në Fakultetin juridik „Justiniani i parë“ pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Arsimin fillor dhe të mesëm i kreu në Shkup dhe më pas e vazhdoi shkollimin në Fakultetin juridik të Universitetit „Sh. Kirilli dhe Metodi“ në Shkup. Studimet deridiplomike i mbaroi në vitin 1978, ndërsa shkollimin e saj e vazhdon me studimet e magjistraturës në të njëjtin fakultet. Në vitin 1994 i mbaron studimet e doktoraturës Cum laude në Fakultetin juridik në Lubjanë, Republika e Sllovenisë. Në vitin

1994 u zgjodh docente, në vitin 1999 profesoreshë inordinare, ndërsa në vitin 2004 profesoreshë ordinare në Katedrën e të drejtës kushtetuese dhe sistem politik në Fakultetin juridik në Shkup.

49 Ueb-faqja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në dispozicion në: <https://pretsedatel.mk/biografija-na-pretsedatelot/> (vizita e fundit: 21.3.2024).

50 Ueb-faqja e LSDM-së. Në dispozicion në: СДСМ - Социјалдемократски Сојуз на Македонија (sds.org.mk) (e vizituar: 26.3.2024).

Profesorja Siljanovska Davkova është autore ose bashkautore e më shumë se 200 titujve nga fusha e drejtësisë, sistemit politik dhe të drejtës kushtetuese. Në vitin 2016 studentët e zgjedhin si profesorin më frymëzues në Fakultetin juridik. Ajo është themeluese e edukimit klinik (praktik) juridik në Republikën e Maqedonisë. Ka qenë drejtuese e Institutit për shkencë juridike dhe juridiko-politike dhe anëtare e Administratës së dekanatit, si dhe shefe e Katedrës për të drejtën kushtetuese dhe sistem politik. Është një nga themelueset e studimeve politike dhe shkencave politike në vend.

Në angazhimin e saj shoqëror ajo ishte anëtare e Komisionit kushtetues në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (1991 – 1992); ministër pa resor në Qeverinë e RM-së (1992 – 1994); kryetare e Trupit koordinues për bashkëpunim me IJEQL-në (Iniciativa juridike e Evropës qendrore dhe lindore), 1992 – 1994, themeluar nga Shoqata e avokatëve amerikanë (American Bar Association – ABA); themeluese dhe anëtare e Këshillit të parë maqedonas të Lëvizjes evropiane; kryetare e Komitetit nacional maqedonas për barazi gjinore (1999 – 2002); kryetare e lobit të grave, Grupit punues për çështje gjinore (2002 – 2004); kryetare e Lëvizjes qytetare të Maqedonisë (2004 – 2005); një nga themeluesit e institutit Euro Ballkan.

Në vitin 1991 ishte anëtare e grupit të ekspertëve të Konferencës së Gjenevës për ish-Jugosllavi. Nga viti 1994 ishte një nga ekspertët për çështjet gjinore të UNDP-së, ndërsa prej v. 1998 është ekspert për çështje zgjedhore në OKB. Ishte anëtare e Komitetit drejtues për demokracinë lokale dhe rajonale (CDLR), pranë Këshillit të Evropës (1996 – 2002). Është anëtare e Shoqatës ndërkombëtare për të drejtën kushtetuese nga viti 1999 deri më sot. Nga viti 2002 deri në vitin 2023 ishte anëtare e Grupit të ekspertëve të pavarur për Kartën evropiane për vetëqeverisje lokale, Këshilli i Evropës, Strasburg ku ishte nënkryetare (2004 – 2012). Në periudhën 2008 – 2016 e përfaqëson Republikën e Maqedonisë në Komisionin e Venecias. Është fituese e shumë çmimeve, përfshirë kontributin ndaj sundimit të ligjit të Misionit të OSBE-së në Shkup dhe të medaljes për punën e saj ndaj barazisë gjinore nga Unioni i grave të Maqedonisë. Ajo në vitin 2019 ishte kandidate në zgjedhjet presidenciale e mbështetur nga VMRO-DPMNE dhe Koalicioni. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve për president të shtetit u zgjodh kundërkandidati i saj Stevo Pendarovski.⁵¹

Në zgjedhjet e parakohshme presidenciale në vitin 2020 Siljanovska Davkova ishte bartëse e listës së kandidatëve për deputetë të VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit në Njësinë zgjedhore 1. Si deputete e pavarur në kuadër të grupit parlamentar të VM-

51 Doracak për zgjedhjet presidenciale 2019. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_ALB.pdf (vizita e fundit: 20.3.2024).

RO-DPMNE-së dhe Koalicionit ajo u zgjodh kryetare e Komisionit për barazi të grave dhe burrave, anëtare e Komisionit për sistem politik dhe Komisionit për arsim, si dhe Këshillit nacional për eurointegrime. Gjithashtu, është anëtare e Komitetit drejtues për bashkëpunim me parlamentin suedez dhe të Komisionit për bashkëpunim me Parlamentin izraelit. Është zëvendës-anëtare e Komisionit për çështje evropiane dhe të delegacionit në OSBE.

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 do të paraqitet si kandidate e VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit.⁵²

Gordana Siljanovska Davkova lindi më 11 maj 1953 në Ohër, e martuar dhe ka dy fëmijë.⁵³

Stevço Jakimovski



Stevço Jakimovski diplomoi në Fakultetin ekonomik në Shkup në vitin 1987. Në vitin 1988 ishte gazetar vullnetar në redaksinë e sportit të Radio Shkupit, e më pastaj në redaksinë informative-politike të programit të dytë të Radio Shkupit.

Nga tetori i vitit 1988 deri në maj të vitit 1990 ishte punonjës profesional-politik në Kryesinë e Unionit të rinisë socialiste të Jugosllavisë. Në vitin 1992 bëhet drejtor i Agjencisë turistike „Katllanova -turs“ – Shkup.

Në shtator të vitit 2000 u zgjodh kryetar i Komunës së Karposhit, ndërsa në nëntor të vitit 2003 ministër i ekonomisë në Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga 2004 deri në 2006 ishte ministër i punës dhe politikës sociale.

Në prill të vitit 2009 fiton në zgjedhjet lokale dhe për herë të dytë bëhet kryetar i Komunës së Karposhit. Katër vjet më vonë, në mars të vitit 2013, garon i pavarur në zgjedhje dhe e merr për herë të tretë besimin e qytetarëve të Karposhit.

52 Ueb-faqja e VMRO-DPMNE-së. Në dispozicion në: [BMPO-ДПМНЕ – BMPO-ДПМНЕ \(vmro-dpmne.org.mk\)](http://vmro-dpmne.org.mk) (vizituar: 26.3.2024).

53 Curriculum Vitae; ueb – faqja e Fakultetit juridik „Iustinian Primus“ Shkup; Në dispozicion në: <http://pf.ukim.edu.mk/wp-content/uploads/2018/02/C.V.-GORDANA-SILJANOVSKA-DAVKOVA-2c-2016.pdf> (vizita e fundit: 21.3.2024).

Në shtator të vitit 2013 e formon partinë Opsioni qytetar për Maqedoninë – GROM, dhe u zgjodh kryetar i saj. GROM-i nga viti 2014 deri më sot është pjesë e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në tetor të vitit 2021, në zgjedhjet lokale Jakimovski kandidohet si kandidat për kryetar komune i GROM-it dhe për herë të katërt e merr besimin e qytetarëve.

Në zgjedhjet presidenciale 2024 do të paraqitet si kandidat i koalicionit i udhëhequr nga partia Opsioni qytetar për Maqedoninë – GROM.⁵⁴

Stevço Jakimovski lindi më 27.8.1960 në Kriva Pallankë, është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.⁵⁵

Bujar Osmani



Bujar Osmani diplomoi në Fakultetin e medicinës në Shkup në vitin 2004. Një pjesë të specializimit të tij e mbaron në Londër, Mbretëri e Bashkuar, në periudhën e viteve 2006 – 2007, ndërsa prej vitit 2012 fiton titullin kirurg specialist. 2014-ën është doktorant i Shkollës për studime të doktoraturës pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi “ në Shkup, ku doktoroi në korrik të vitit 2018.

Në vitin 2008 u emërua ministër i shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe këtë funksion e kryen deri në vitin 2011. Në vitin 2011 ishte kirurg specialist në Klinikën universitare për Kirurgji digjестive në Shkup. Në të njëjtin vit në kuadër të partisë amë Bashkimi demokratik për integrim u emërua Sekretar i komunikimit me publikun pranë kryesisë së partisë.

Nga viti 2017 deri në korrik të vitit 2020 e kreu funksionin zëvendëskryeministër i Qeverisë e ngarkuar për çështjet evropiane. Si udhëheqës i Sekretariatit për çështje evropiane, Osmani njëkohësisht e kryen funksionin Koordinator nacional për shpërndarjen e ndihmës së huaj dhe IPA fondeve në vend.

⁵⁴ Ueb-faqja e GROM-it. Në dispozicion në: Мојот потпис за Стевчо Јакимовски – Граѓанска Опција за Македонија (grom.mk) (vizita e fundit: 26.3.2024).

⁵⁵ Ueb-faqja e Komunës së Karposhit. Në dispozicion në: <https://karpos.gov.mk/градоначалник/> (vizita e fundit: 15.3.2024).

Nga viti 2018 deri në korrik të vitit 2020 u emërua Shef i delegacionit shtetëror dhe Kryenegociator me Bashkimin Evropian.

Osmani ishte anëtar i përhershëm i Shtabit qeveritar të krizave për ballafaqim me KOVID-19, ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2020 u emërua Kryekoordinator i shtabeve lokale të krizave dhe Shtabit të krizave të Qytetit të Shkupit.

Më 30 gusht të vitit 2020 Bujar Osmani zgjidhet ministër i punëve të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në zgjedhjet presidenciale 2024 do të paraqitet si kandidat i koalicionit të udhëhequr nga BDI.⁵⁶

Bujar Osmani lindi më 11 shtator 1979 në Shkup, është i martuar dhe ka tre fëmijë.⁵⁷

Biljana Vankovska Cvetkovska



Biljana Vankovska Cvetkovska është doktor i shkencave juridike dhe profesor ordinar në Fakultetin filozofik të Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Është udhëheqëse e Qendrës për ndryshime globale. Është përfaqësuese e Institutit për siguri, mbrojtje dhe paqe të Fakultetit filozofik në rrjetin e think tanks dhe institucioneve akademike të OSBE-së (OSCE Network of Think Tanks and Academic Institutions) nga viti 2017 deri më sot. Ishte anëtare e këshillit ekzekutiv të Komitetit për shoqërinë dhe forcat e armatosura në kuadër të Shoqatës ndërkombëtare për shkencë politike (IPSA). Ajo ishte përfaqësuese e Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht të Institutit për siguri, mbrojtje dhe paqe në Konsorciumin e akademive ushtarake dhe instituteve për siguri në kuadër të Partneritetit për paqe (që nga themelimi në vitin 1999 deri në vitin 2003).

⁵⁶ Ueb-faqja e Bashkimit Demokratik për Integrim. Në dispozicion në: Bujar Osmani: Të përqëndrohemi në heqjen e barrierave që na mbajnë jashtë rrugës së progresit e zhvillimit të shekullit XXI - Bashkimi Demokratik Për Integrim (bdi.mk) (vizita e fundit: 25.3.2024).

⁵⁷ Ueb-faqja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Në dispozicion në: <https://vlada.mk/minister/BujarOsmani> (vizita e fundit: 15.3.2024).

Është redaktore e këshillave redaktues të shumë revistave të dalluara shkencore në vende të ndryshme. Është anëtare e shoqatave të shumta shkencore botërore, ndërsa është anëtare e disa nismave lidhur me qeverisjen globale dhe çarmatimin në shekullin 21.

Ka botuar tekstet shkollore në vijim: „Mbrojtja dhe e drejta“, „Sistemi politik“ (dy botime), „Institucionet evropiane“ (dy botime), „Siguria ndërkombëtare“ dhe „Drejtesia tranzicionale“. Ishte anëtare e Grupit ndërresorjal të ekspertëve për hartimin e Raportit mbi përputhshmërinë e legjislacionit të vendit me standardet dhe kërkesat e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Në angazhimin e saj publik, Vankovska ishte zëdhënëse publike e Nismës për KOM-RA në Republikën e Maqedonisë. Ishte nënkryetare e Lëvizjes qytetare të Maqedonisë në vitin 2004 – 2005, dhe ishte veçanërisht aktive në fushatën e referendumit për ligjin për kufijtë komunalë të vitit 2004. Ajo ishte ndër themelueset e „Plenumit të profesorëve“, aktive në protestat kundër kufizimit të së drejtës së abortit, protestave kundër Marrëveshjes së Prespës dhe ndryshimit të Kushtetutës.

Në zgjedhjet presidenciale 2024 do të paraqitet si kandidatë e së majtës „Levica“.

Biljana Vankovska Cvetkovska lindi më 14 nëntor 1959 në Shkup dhe është nënë e tre fëmijëve.⁵⁸

Arben Taravari



Arben Taravari është neurolog me përvojë shumëvjeçare në Klinikën universitare për neurologji në Shkup. Në vitin 1998 diplomoi në Fakultetin e mjekësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“, ndërsa në vitin 2006 mbaron specializimin për neurologji në Klinikën universitare për neurologji. Specializimin e dytë për mjekësi familjare në Fakultetin e mjekësisë, Universiteti „Sh. Kirili dhe Metodi“, e mbaron në vitin 2011. Është kryetar i bordit të Klinikës universitare për neurologji, si dhe anëtar i bordit të revistës mjekësore *Mediicus* dhe *Vox Medici*.

⁵⁸ Ueb-faqja e partisë „Levica“. Në dispozicion në: <https://levica.mk/pretsedatelski-kandidat-2024/> (vizita e fundit: 15.3.2024).

Ka botuar disa libra dhe punime shkencore ndër të cilat: „Migrena, kokëdhimbja dhe sindromet e dhimbshme“ (2016), „Praktikum neurologjik“ (2014), ndërsa disertacioni i tij i doktoraturës është në temën „Gjetjet klinike dhe gjenetike te pacientët me sëmundjen idiopatike të Parkinsonit“ (2011).

Karriera më e fundit politike e Taravarit fillon me Aleancën për Shqiptarët në vitin 2016 e udhëhequr nga kryetari Ziadin Sela, ku Taravari u zgjodh sekretar i përgjithshëm. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 Aleanca për Shqiptarët fitoi tri vende deputetësh, përfshirë edhe të Taravarit.

Më 1 qershor të vitit 2017 Taravari u emërua ministër i shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, funksionin të cilin e ka kryer deri më 31.10.2017.

Dr Arben Taravari në funksionin e kryetarit të komunës së Gostivarit vjen në vitin 2017, pas fitores në zgjedhjet lokale duke e fituar atëbotë kryetarin aktual të BDI-së Nevzat Bejtën.⁵⁹ Në vitin 2021 pas mbarimit të mandatit të parë Taravari sërish kandidohet si kandidat i Aleancës për Shqiptarët dhe fiton mandatin e dytë si kryetar i komunës së Gostivarit.⁶⁰

Pas emërimit të Taravarit nga Kuvendi qendror i partisë si ushtrues detyre kryetar i partisë në dhjetor të vitit 2022, në Kongresin e tretë të jashtëzakonshëm të partisë Aleanca për Shqiptarët Taravari zgjidhet kryetar i partisë.⁶¹

Në shkurt të vitit 2024 shpall kandidaturën për presidentin e vendit me propozimin e Kryesisë së AA-së, me mbështetje të partive opozitare të shqiptarëve. Kandidatura vjen në kohën e tensioneve brenda partiake në Aleancën për Shqiptarët.⁶²

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 do të paraqitet si kandidat i koalicionit „VLEN“.⁶³

Arben Taravari lindi më 9 prill 1973 në Gostivar. Është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.⁶⁴

59 Ueb-faqja e komunës së Gostivarit. Në dispozicion në: <https://gostivari.gov.mk/dr-arben-taravari/> (vizita e fundit: 15.3.2024).

60 Doracak për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut во 2021. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/wp-content/uploads/2021/12/belegexemplar_2021_the_republic_of_north_macedonias_2021_local_elections_handbook_alb_version.pdf (vizita e fundit: 25.3.2024).

61 Ueb-faqja e Aleancës për Shqiptarët. Në dispozicion në: Then, the taravari - the alliance for the Albanians (aleanca.mk) (vizita e fundit: 26.3.2024).

62 Арбен Таравари е претседателскиот кандидат на албанската опозиција (slobodnaevropa.mk) (vizita e fundit: 26.3.2024).

63 Ueb-faqja e Alternativës Në dispozicion në: <https://alternativa.org.mk> (vizita e fundit: 26.3.2024).

64 Ueb-faqja e Vistinomer. Në dispozicion në: <https://vistinomer.mk/arben-taravari-gradonachalnik-na-gostivar/> (vizita e fundit: 15.3.2024).

Maksim Dimitrievski



Maksim Dimitrievski diplomoi në Fakultetin juridik në Shkup. Magjistroi në vitin 2021 në temën „Roli i vetëqeverisjes lokale në gjendje të jashtëzakonshme dhe krize, në kushtet e epidemisë me vështrim mbi Komunën e Kumanovës“. Ka përvojë pune shumëvjeçare si afarist privat.

Karrierën politike e fillon si aktivist i ri në Lidhjen socialdemokrate të Maqedonisë. Në vitin 2008 bëhet pjesë e Këshillit të Komunës së Kumanovës, e më vonë edhe kryetar i Këshillit nga viti 2012 deri në vitin 2016. Karrierën politike e vazhdon si deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe kryetar i Komisionit për mbrojtje dhe siguri.

Në zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2017 bëhet kryetar i Komunës së Kumanovës. Pas mbarimit të mandatit të parë, kandidohet për herën e dytë, por si kandidat i pavarur, dhe për shkak të vendimit për pjesëmarrje të pavarur në zgjedhjet lokale të vitit 2021 përjashtohet nga partia LSDM. Maksim Dimitrievski fiton në zgjedhjet lokale në Kumanovë dhe bëhet kryetar i Komunës së Kumanovës për herën e dytë me mandat 2021 – 2025.⁶⁵ Në tetor të vitit 2024 e formon partinë e re politike „Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë tonë“ dhe njëkohësisht zgjidhet kryetar i partisë.

Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 do të paraqitet si kandidat i „Lëvizjes ZNAM – Për Maqedoninë tonë“.⁶⁶

Maksim Dimitrievski lindi më 29 nëntor 1975 në Kumanovë, është i martuar dhe baba i tre fëmijëve.⁶⁷

65 Doracak për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2021. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/wp-content/uploads/2021/12/belegexemplar_2021_the_republic_of_north_macedonias_2021_local_elections_handbook_alb_version.pdf (vizita e fundit: 25.3.2024).

66 Ueb-faqja e Lëvizjes ZNAM – Për Maqedoninë tonë. Në dispozicion në: Движење ЗНАМ - За наша Македонија - Движење ЗНАМ - За наша Македонија (dvizenjeznam.org.mk) (vizita e fundit: 25.3.2024).

67 Ueb-faqja e Komunës së Kumanovës. Në dispozicion në: <https://kumanovo.gov.mk/gradonacalnik/> (vizita e fundit: 15.3.2024).

